



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:233936  
Datë: 11.09.2024  
Numri i dokumentit: 06145012

**C-IV-13-4217**

*Parashtruesi i Ankesës*

**Korporata Energjetike e Kosovës – SH.A**, Prishtinë  
*Kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) ( NSH “Kosovatrans” Kamenicë në likuidim)**, Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 11 shtator 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI109-0055 datë 20 nëntor 2013.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 31 dhjetor 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtror një kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI109-0055 datë 20 nëntor 2013 (tani e tutje Vendimi), me të cilin kërkesa për pagesa për fatura të papaguara të furnizimit me energji elektrike, periudhën 9 shtator 2002 e gjer me 17 korrik 2006, kërkesë në shumë prej 479.36 (katër shtatë nëntë tre gjashtë) Euro, ndaj NSH “Kosovatrans” (në likuidim), është aprovuar pjesërisht dhe atë në shumë prej 251.74 (dy pesë një shtatë katër) Euro gjersa pjesa e mbetur në shumë prej 227.62 (dy dy shatë gjashtë dy) Euro është refuzuar.

Kërkesa kreditore e kontestuar, nga ankuesi, konsiston për njehsorin DGL9006044, e cila nga dëshmitë e parashtruar nga ankuesi evidentohet në emër të personit juridik – “M B C” Shpk.

Ankuesi vendimin e AL e kundërshtoj për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike respektivisht aplikimit të gabuar të dispozitave materiale.

Ankuesi obligimeve mbi pagesën e energjisë së shpenzuar elektrike, të NSH, i referohet transaksioneve të konsumatorit e që sipas ankuesit përmbajnë shënime të sakta dhe të besueshme.

Ankuesi kundërshtoj arsyetimin e Vendimit të AL, me pretendimet se pavarësisht faktit se NSH është privatizuar dhe se është obligim i pronarit të ri mbi pagesën e borxhit, se kjo është çështje

e brendshme e AKP dhe se nuk është çështje e ankuesit në këtë rast se si duhet të zgjidhet kjo çështje.

Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa e tij kreditore, për shumën e refuzuar prej 227.62 (dy dy shatë gjashtë dy) Euro, të aprovohet.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e pasqyrës, mbi borxhin e konsumatorit, për njehsorin DGL9006044, nga e cila shihet pasqyra e borxhit për muajin dhjetor 2005 si dhe muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2006, dhe
- Kopja e gjendjes mbi transaksionet, për njehsorin DGL9006044, - të evidentuar në emër të personit juridik “M B C” Shpk.

AKP me 6 tetor 2017, parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP fillimisht pohon se AL me rastin e vendosjes ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore. AKP konsideron se kërkesa për rishikim ndaj Vendimit të AL e parashtruar pranë konsiderohet e pasafatshme. AKP tutje pohon se kërkesa për rishikim-ankesa, e ankueses, nuk përmban argumentet e saj ligjore ashtu siç edhe parashihet sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP dhe dispozitave ligjore të Ligjit për procedurën kontestimore - LPK. AKP përfundimisht kontestoj argumentet e parashtruar nga ankuesit, lidhur me obligimet e NSH dhe thirret mbi obligimet e blerësit me rastin e privatizimit të NSH. Nga gjitha arsyet AKP propozoj që kërkesa për rishikim të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, ankuesi parashtroj kopjen e kërkuar të Vendimit të AL. Përgjigja e AKP ju dorëzua ankuesit me 11 tetor 2017 por edhe, sipas urdhrin të gjykatës, me 11 qershor 2024.

Nuk u parashtrua përgjigje.

Gjykata me 29 gusht 2014 lëshoj një urdhër për ankuesin me të cilin u kërkua që të parashtrohet kopja e Marrëveshjes mbi privatizimin e NSH “Modeli”.

AKP me datë 9 shtator 2024 përmbushi urdhrin e gjykatës dhe parashtroj kopjen e kërkuar të marrëveshjes.

### **Arsyetimi Ligjor**

Kërkesa për rishikim – ankesa konsiderohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Ankuesi kërkon kompensimin e pjesës së refuzuar të kompensimit për shumën e refuzuar prej 227.62 (dy dy shatë gjashtë dy) Euro.

AL në Vendimin e saj pohon se NSH është privatizuar me 23 mars 2006 fakt ky që nuk është mohuar as nga ankuesi, por sipas pohimeve të tij konsideron se kjo është çështje e brendshme e AKP dhe se nuk është çështje e ankuesit në këtë rast se si duhet të zgjidhet kjo çështje

Gjykata konsideron se marrëveshjet e palëve, e që në rastin konkret përfshinë edhe detyrimet e mbetura, janë çështje dy palëshe të cilat duhet të pasqyrohen dhe pranohen nga ana e kreditorëve si në rastin konkret. Në rastin konkret kemi pëlqim për marrje përsipër të borxhit, siç parashihet sipas nenit 430 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L-077) ligj ky në fuqi me rastin e marrjes së Vendimit nga ana e AL. Sipas kësaj dispozite parashihet marrja përsipër e borxhit që bëhet midis debitorit dhe marrësit përsipër të borxhit; për të cilën kreditori ka dhënë pëlqimin. Ky pëlqim dhe pranim është bërë me marrëveshjen mbi bartjen e akcioneve-privatizimit të NSH, e lidhur me 23 mars 2006.

Për më tepër edhe nga kopjet e pasqyrës, mbi borxhin e konsumatorit, për njehsorin DGL9006044, shihet se ky njehsor evidentohet në emër të personit juridik "M B C" Shpk. ku dhe është pasqyruar obligimi i konsumatorit të ri, nga muaji janar gjer mars të vitit 2006.

Përfundimisht nga Kopja e gjendjes mbi transaksionet, për njehsorin DGL9006044, - të evidentuar në emër të personit juridik "M B C" Shpk me datë 24 dhjetor 2005, gjer me datë kur edhe ishte obligimi i NSH, shihet gjendja e shumës së mbetur në lartësi prej 168.43 Euro gjersa AL ka pranuar shumën në lartësi prej 251.74 (dy pesë një shtatë katër) Euro, e që bie që shuma e paguar është mbi shumën e pasqyruar me datë 10 mars 2006, në shumë prej 248.31 (dy katër tetë tre një) Euro.

Lidhur me pohimet e AKP se kërkesa për rishikim-ankesa duhet të konsiderohet e pasafatshme gjykata e konsideron si të pabazuar sepse nuk është ofruar asnjë dëshmi që do të dëshmonte datën e pranimin të Vendimit të AL, nga e cila datë rrjedh edhe afati mbi parashtrimin e kërkesës për rishikim-ankesës pranë DHPGJS.

Andaj, nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

### **Taksa Gjyqësore**

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000.00 €.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar